



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**A nr. 322/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazić, dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia e Ashkanlive për Integrim (PAI) dega në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Ashkanlive të Kosovës (PDAK), dega në Ferizaj për shkak të bërjes së fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2013, mori këtë:

**VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia e Ashkanlive për Integrim (PAI), dega në Ferizaj.

**Arsyetim**

Me datën 23.10.2013, subjekti politik PAI, ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendon se në Ferizaj subjekti politik PDAK-ja, ka mbajtur fushatë zgjedhore në të cilën ishin pjesëmarrës mbi 50% fëmijë të pranishëm . Parashtruesi i ankesës ka theksuar se me ligj fëmijet nuk mund të jenë pjesë e fushatave . Po ashtu në ankesën e PAI-it, thuhet se nënkryetari Qazim Rrahmani me disa persona tjerë kanë hapur një adresë elektronike në emrin e subjektit politik PAI të ashtuquajtur PAI –i, Ferizaj. Ku nëpërmjet kësaj adrese po ofendohen dhe kercenojnë opinionin e gjerë dhe humb imazhin duke na krijuar probleme. Kësaj ankesë i janë bashkangjitur si provë disa fotografi.

PZAP-i, e informoi subjektin politik PDAK në kuptim të nenit 4, paragrafi 3, të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 24.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 25.10.2013. PZAP-i, e pranoi përgjigjen e kërkuar nga PDAK-ja sipas afatit të caktuar, dhe në këtë përgjigje ceket se pretendimet e PAI-së janë shpifje , dhe nuk pranojnë se është hapur një adresë elektronike, nga ana e tyre dhe kerkojnë që të hetohet ky rast me tutje, thuhet në përgjigje në ankesë nga PDAK-ja.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

**ankesa është e pabazuar**

Sipas ankesës së parashtruar në PZAP, pala ankuese pretendon se PDAK-ja, ka organizuar fushatë zgjedhore në Ferizaj ku mbi 50% ishin fëmijë të pranishëm. Si dhe kanë hapur një adresë elektronik në emër të subjektit politik PAI- Ferizaj. PZAP-i konstatoi se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë ngase pretendimet e theksuara në ankesë nuk janë mbështetur në prova nga pala ankuese që do të ndikonte në marrjen e vendimit. Përveç asaj që u tha më

lartë, në legjislacionin për zgjedhjet në Kosovë nuk ekziston ndonjë ndalesë apo sanksion i paraparë me ligj për pjesëmarrjen e fëmijëve në fushatë zgjedhore.

PZAP-i pretendimet e tilla i vlerësoi si të pabazuar dhe te pa argumentuara, andaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në Prishtinë**

Anr. 322/2013 më datën 25.10.2013.



**Kryesuesi i Panelit  
Nehat Idrizi**

#### ***Këshillë Juridike:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*